



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:020777

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05804825

C-IV-14-7396

Parashtruesi i kërkesës

E M fshati L, Lipjan

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (KB “Agroprodukti” në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55. Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 11 qershor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN138-0010 datë 4 nëntor 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 5 dhjetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtron një kërkesë për rishikimin e Vendimit (në tekstin e më tutjeshëm Vendimi PRN138-0010 datë 4 nëntor 2014, lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (në tekstin e më tutjeshëm AL) me anë të cilit, kërkesa për kompensimin e pagave të pagave të pa-paguara për periudhën prej 1 shkurt 2007 e gjer më 23 qershor 2014, në shumë prej 8,097.75 (tetë zero nëntë shtatë shtatë pesë) Euro, ndaj KB “Agroprodukti”, është refuzuar.

Ankuesi Vendimin e AL e konteston për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

Ankuesi pohon se pranë KB ishte i punësuar për kohë të pacaktuar.

Ankuesi tutje konteston bazueshmërinë e Vendimit të AL, në rastin kur i referohet Ligjit mbi punën e bashkuar, duke marr parasysh arsimimin e punëtorëve si dhe arsyet se nuk janë informuar me shkrim mbi afatet e realizimit e kërkesave të tyre.

Nga të gjitha arsyet si më lartë ankuesi kërkoj që kërkesa e tij mbi pagat të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 5 dhjetor 2023, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohoj se AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe se dispozitat ligjore i ka aplikuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu theksoj se ankesa nuk përmban argumentet ligjore, të përcaktuar sipas dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore. Përfundimisht AKP konsideron se kërkesa e ankuesit është e pa-argumentuar dhe e parashkuar në kuptim dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP respektivisht Ligjit për punën e bashkuar - LPB. Nga gjitha AKP propozoj që ankesa të hedhet si e pa-pranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Përgjigja e AKP, me urdhër të gjykatës, ju dorëzua ankuesit me 5 shkurt 2024.

Ankuesi nuk parashtroj përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim -ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Sipas dispozitës së cekur si më lartë, ankuesi përkundër pohimeve, sipas kërkesës për rishikim-ankesës, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi, me të cilin do të dëshmohej e drejta në paga në shumën dhe periudhën e kërkuar.

Në rastin konkret gjykata, pavarësisht Vendimit të AL, konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe

- c. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave përfshirë kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë

Ankuesi, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat e pa-paguara ashtu që do të dëshmonte, me dëshmi materiale, ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe paragrafit 1.7 (kërkesat e pasiguruara) të po të njëjtit nen, si edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Ankuesi ka paguar taksën gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar